



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1751 Prot

Tiranë, më 13.12.2019

V E N D I M

Nr.185, datë 13.12.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Fushë-Arrëz, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Fushë-Arrëz,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha

njësiti e vetëqeverisjes vendore (*61 bashkitë e vendit*), ku përfshihet edhe Bashkia Fushë-Arrëz.

Verifikimi u realizua fillimisht nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim, i cili më pas, vazhdoi në zyrat e Komisionerit. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit, ka rezultuar se, Bashkia Fushë-Arrëz, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhrin nr.14, datë 16.1.2019, të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz, “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë-Arrëz, të Njësive Administrative dhe institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, të vitit 2019*”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.147 prot., datë 24.12.2018.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Fushë-Arrëz, së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **53** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **2** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **11** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **40** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Aktualisht, institucioni, po punon për hartimin e një strukture të re organizative, përgatitja e të cilës është në proces.

Gjatë procesit të verifikimit, u konstatua se, **14** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **35** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi të përkohshëm dhe jo sipas procedurave të konkurrimit që parashikon ligji në këto raste; ndërsa **4** pozicione të shërbimit civil rezultuan vende të lira.

Konkretisht, rastet e emërimit në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. *****, në pozicionin e punës “*Inspektor për Koordinimin, Zhvillimin për Arsimin, Kulturën, Rininë, Sportet dhe Shëndetësinë*”, emëruar me aktin nr. 33/1, datë 20.4.2016.
2. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve*”, emëruar me aktin nr. 60/2, datë 22.10.2015.
3. *****, në pozicionin e punës “*Specialist protokolli*”, në Nj/A Qafë Mali, emëruar me aktin nr. 11, datë 10.2.2016.
4. *****, në pozicionin e punës “*Specialist i Menaxhimit dhe Administrimit Territorit*”, në Nj/A Qafë Mali, emëruar me aktin nr. 60/1, datë 22.10.2015.
5. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Ndihmës Ekonomike*”, në Nj/A Blerim, emëruar me aktin nr. 103, datë 8.8.2016.

6. *****, në pozicionin e punës “*Specialist protokolli*”, në Nj/A Iballë, emëruar me aktin nr. 60/4, datë 22.10.2015.
7. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Ndhmës Ekonomike*”, në Nj/A Iballë, emëruar me aktin nr. 66, datë 2.11.2015.
8. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Tatim Taksa*”, në Nj/A Iballë, emëruar me aktin nr. 66, datë 2.11.2015.
9. *****, në pozicionin e punës “*Inspektor Veteriner*”, në Nj/A Iballë, emëruar me aktin nr. 60/4, datë 22.10.2015.
10. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Protokolli*”, në Nj/A Fierzë, emëruar me aktin nr. 60/3, datë 22.10.2015.
11. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Pyje dhe Kullota*”, në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, emëruar me aktin nr. 103, datë 8.8.2016.
12. *****, në pozicionin e punës “*Specialist i Administrimit të Pyjeve*”, emëruar me aktin nr. 47/1, datë 23.5.2016.
13. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës në Sektorin e Burimeve Njerëzore*”, emëruar me aktin nr. 270, datë 3.9.2019.
14. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Arkiv Protokolli*”, emëruar me aktin nr. 204, datë 23.7.2019.
15. *****, në pozicionin e punës “*Specialist i Prokurimeve Publike*”, emëruar me aktin nr. 342, datë 30.10.2019.
16. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Sociale*”, emëruar me aktin nr. 263, datë 3.9.2019.
17. *****, në pozicionin e punës “*Specialist i Çështjeve Sociale*”, emëruar me aktin nr. 273, datë 3.9.2019.
18. *****, në pozicionin e punës “*Specialist i Planifikimit të Territorit*”, emëruar me aktin nr. 174, datë 22.5.2017.
19. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Ujitje, Bujqësie*”, emëruar me aktin nr. 145, datë 10.10.2016.
20. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Rrugëve Rurale*”, emëruar me aktin nr. 22/1, datë 23.5.17.3.2016.
21. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Arkiv-Protokolli*”, në Nj/A Blerim, emëruar me aktin nr. 94, datë 5.3.2018.
22. *****, në pozicionin e punës “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*”, në Nj/A Fierzë, emëruar me aktin nr. 82, datë 15.3.2017.
23. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Finance*”, në Nj/A Fierzë, emëruar me aktin nr. 27, datë 5.2.2018.
24. *****, në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor*”, emëruar me aktin nr. 77, datë 15.3.2017.
25. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Kadastrë*”, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, emëruar me aktin nr. 84, datë 20.3.2017.

26. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Menaxhimi*”, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, emëruar me aktin nr. 317, datë 21.7.2018.
27. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Pyje dhe Kullota*”, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, emëruar me aktin nr. 74, datë 16.2.2018.
28. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Pyje dhe Kullota*”, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, emëruar me aktin nr. 300, datë 24.9.2019.
29. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Pyje dhe Kullota*”, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, emëruar me aktin nr. 68, datë 15.3.2017.
30. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Turizmi pranë BIO Ishull*”, emëruar me aktin nr. 280, datë 4.9.2019.
31. *****, në pozicionin e punës “*Specialist për Marrëdhënien me Bujqësinë dhe Fermerët pranë BIO Ishull*”, emëruar me aktin nr. 279, datë 4.9.2019.
32. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Pagash dhe Kontributesh*”, emëruar me aktin nr. 276, datë 3.9.2019.
33. *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Auditit të Brendshëm*”, emëruar me aktin nr. 278, datë 4.9.2019.
34. *****, në pozicionin e punës “*Specialist i Auditit të Brendshëm*”, emëruar me aktin nr. 277, datë 3.9.2019.
35. *****, në pozicionin e punës “*Specialist Finance*”, në Nj/A Iballë, emëruar me aktin nr. 275, datë 3.9.2019.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit në fjalë dhe nisur nga detyrimi i parashikuar në nenin 111, të ligjit si më lart, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t'u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV, *“Pranimi në shërbimin civil”*, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”* dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”*.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të evidentuara si më poshtë:
 - *****, në pozicionin e punës *“Inspektor për Koordinimin, Zhvillimin për Arsimin, Kulturën, Rininë, Sportet dhe Shëndetësinë”*, emëruar me aktin nr. 33/1, datë 20.4.2016.
 - *****, në pozicionin e punës *“Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve”*, emëruar me aktin nr. 60/2, datë 22.10.2015.

- ******, në pozicionin e punës “*Specialist protokolli*”, në Nj/A Qafë Mali, emëruar me aktin nr. 11, datë 10.2.2016.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist i Menaxhimit dhe Administrimit Territorit*”, në Nj/A Qafë Mali, emëruar me aktin nr. 60/1, datë 22.10.2015.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Ndihmës Ekonomike*”, në Nj/A Blerim, emëruar me aktin nr. 103, datë 8.8.2016.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist protokolli*”, në Nj/A Iballë, emëruar me aktin nr. 60/4, datë 22.10.2015.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Ndihmës Ekonomike*”, në Nj/A Iballë, emëruar me aktin nr. 66, datë 2.11.2015.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Tatim Taksa*”, në Nj/A Iballë, emëruar me aktin nr. 66, datë 2.11.2015.
- ******, në pozicionin e punës “*Inspektor Veteriner*”, në Nj/A Iballë, emëruar me aktin nr. 60/4, datë 22.10.2015.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Protokolli*”, në Nj/A Fierzë, emëruar me aktin nr. 60/3, datë 22.10.2015.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Pyje dhe Kullota*”, në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, emëruar me aktin nr. 103, datë 8.8.2016.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist i Administrimit të Pyjeve*”, emëruar me aktin nr. 47/1, datë 23.5.2016.
- ******, në pozicionin e punës “*Përgjegjës në Sektorin e Burimeve Njerëzore*”, emëruar me aktin nr. 270, datë 3.9.2019.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Arkiv Protokolli*”, emëruar me aktin nr. 204, datë 23.7.2019.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist i Prokurimeve Publike*”, emëruar me aktin nr. 342, datë 30.10.2019.
- ******, në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Sociale*”, emëruar me aktin nr. 263, datë 3.9.2019.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist i Çështjeve Sociale*”, emëruar me aktin nr. 273, datë 3.9.2019.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist i Planifikimit të Territorit*”, emëruar me aktin nr. 174, datë 22.5.2017.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Ujitje, Bujqësie*”, emëruar me aktin nr. 145, datë 10.10.2016.
- ******, në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Rrugëve Rurale*”, emëruar me aktin nr. 22/1, datë 23.5.17.3.2016.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Arkiv-Protokolli*”, në Nj/A Blerim, emëruar me aktin nr. 94, datë 5.3.2018.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist i Ndihmës Ekonomike*”, në Nj/A Fierzë, emëruar me aktin nr. 82, datë 15.3.2017.

- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Finance*”, në Nj/A Fierzë, emëruar me aktin nr. 27, datë 5.2.2018.
- ******, në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor*”, emëruar me aktin nr. 77, datë 15.3.2017.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Kadastrë*”, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, emëruar me aktin nr. 84, datë 20.3.2017.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Menaxhimi*”, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, emëruar me aktin nr. 317, datë 21.7.2018.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Pyje dhe Kullota*”, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, emëruar me aktin nr. 74, datë 16.2.2018.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Pyje dhe Kullota*”, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, emëruar me aktin nr. 300, datë 24.9.2019.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Pyje dhe Kullota*”, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, emëruar me aktin nr. 68, datë 15.3.2017.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Turizmi pranë BIO Ishull*”, emëruar me aktin nr. 280, datë 4.9.2019.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist për Marrëdhënien me Bujqësinë dhe Fermerët pranë BIO Ishull*”, emëruar me aktin nr. 279, datë 4.9.2019.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Pagash dhe Kontributesh*”, emëruar me aktin nr. 276, datë 3.9.2019.
- ******, në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Auditit të Brendshëm*”, emëruar me aktin nr. 278, datë 4.9.2019.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist i Auditit të Brendshëm*”, emëruar me aktin nr. 277, datë 3.9.2019.
- ******, në pozicionin e punës “*Specialist Finance*”, në Nj/A Iballë, emëruar me aktin nr. 275, datë 3.9.2019.

Punonjësja të rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës si “*Specialist Audit*”, ku ajo gëzon statusin e nëpunësit civil, në kushtet kur, një nga pozicionet “*specialist*” në këtë sektor, në kuptim të ligjit, është vend i lirë.

2. Njësia përgjegjëse, të shpallë menjëherë për t’u plotësuar pozicionet e shërbimit civil që, në kuptim të ligjit, janë vende vakante dhe ato të plotësuara në kundërshtim me ligjin dhe më tej, të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit, sipas strukturës që është në fuqi në momentin e zbatimit të detyrave të këtij vendimi.
3. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108,

datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

4. Të përmyllet procesi i mbikëqyrjes, i cili është finalizuar me vendimin paralajmërues nr.173, datë 30.12.2016, të Komisionerit dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt, sipas urdhërimeve të dispozitivit të këtij vendimi.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **5 (pesë) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Fushë-Arrëz, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjatimit të nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
7. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz, Prefektura e Qarkut Shkodër dhe Ministria e Brendshme. Njësia Përgjegjëse të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha